



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**KODI I ETIKËS GJYQËSORE PËR GJYKATËSIT E EMËRUAR NË
REGJISTRIN E GJYKATËSVE NDËRKOMBËTARË TË DHOMAVE
TË SPECIALIZUARA TË KOSOVËS**

(miratuar më 14 mars 2017
ndryshuar më 24 mars 2023)



KODI I ETIKËS GJYQËSORE PËR GJYKATËSIT E EMËRUAR NË REGJISTRIN E GJYKATËSVE NDËRKOMBËTARË TË DHOMAVE TË SPECIALIZUARA TË KOSOVËS

HYRJE	1
KREU 1 DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	2
Neni 1 Miratimi i kodit	2
Neni 2 Përdorimi i termave	2
KREU 2 PARIMET KRYESORE.....	2
Neni 3 Pavarësia	2
Neni 4 Paanësia	2
Neni 5 Ndershmëria	3
Neni 6 Fshehtësia	3
Neni 7 Zelli	3
Neni 8 Veprimtaria gjatë procedurave gjyqësore	4
Neni 9 E drejta e shprehjes dhe pjesëmarrjes në shoqata	4
Neni 10 Veprimtari të tjera.....	4
Neni 11 Dekoratat dhe çmimet	5
Neni 12 Respektimi i kodit	5
KREU 3 SJELLJE KUNDËRVAJTËSE.....	5
Neni 13 Sjellje kundërvajtëse të rënda	5
Neni 14 Sjellje kundërvajtëse më pak të rënda	6
KREU 4 PROCEDURA DISIPLINORE	6
Neni 15 Ankesat.....	6
Neni 16 E drejta për t'u mbrojtur.....	7
Neni 17 Hedhja poshtë e ankesave me procedurë të shkurtuar	7
Neni 18 Komisioni Disiplinor	7
Neni 19 Pezullimi nga detyra.....	8
Neni 20 Seanca plenare.....	9
Neni 21 Përrjashtimi nga Regjistri.....	9
Neni 22 Masat disiplinore.....	9
KREU 5 DISPOZITË PËRMBYLLËSE.....	10
Neni 23 Klasifikimi i procedurave	10

Hyrje

Gjykatësit e emëruar në Regjistrin e Gjykatësve Ndërkombëtarë të Dhomave të Specializuara të Kosovës, (përkatësisht, “gjykatësit” dhe “Regjistri”);

Duke rikujtuar se gjykatësit janë persona me karakter moral të lartë, të paanshëm dhe të ndershëm sikurse përcaktohet në paragrafin 1 të nenit 27 të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyren e Prokurorit të Specializuar (‘Ligji’);

Duke rikujtuar parimet e pavarësisë dhe paanësisë gjyqësore dhe kryerjes së duhur të procedurave përcaktuara në nenin 27 dhe nenin 31 të Ligjit;

Duke rikujtuar se paragrafi 4 i nenit 31 të Ligjit përcakton se një gjykatës mund të përjashtohet në qoftë se gjykatësit e emëruar në Regjistrë, gjatë një seance plenare vendosin me shumicë absolute se gjykatësi në fjalë nuk i plotëson më kushtet e neneve 27 dhe 31 të Ligjit;

Duke marrë shënim se parimet e mëposhtme janë të vlefshme pavarësisht nëse një gjykatës i Regjistrin, është ose nuk është caktuar në një trup gjykues;

Duke marrë shënim deklaratën solemne paraparë në nenin 36 të Ligjit;

Duke qenë të ndërgjegjshëm se pavarësia dhe paanësia e gjykatësve janë themelore për mbrojtjen e të drejtave të të akuzuarve dhe për garantimin e besimit të publikut në pavarësinë, paanësinë dhe transparencën e procesit gjyqësor;

Duke qenë të ndërgjegjshëm se gjykatësit janë anëtarë të një organi kolegjal, ku të gjithë gjykatësit synojnë arritjen e një drejtësie të ndershme dhe të paanshme;

Duke qenë të ndërgjegjshëm për nevojën e udhëzimeve të përgjithshme që kontribuojnë në mbështetjen dhe garantimin e pavarësisë dhe paanësisë gjyqësore, dhe me synim mundësimin e legjitimitetit, ndershmerisë, efektivitetit dhe transparencës së procesit gjyqësor në Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe rrjedhimisht fuqizimin e besimit publik në Dhomat e Specializuara;

Duke marrë parasysh Kapitullin VII të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Parimet Themelore të Kombeve të Bashkuara mbi Pavarësinë e Gjyqësorit (1985), Parimet e Bangalores për Etikën Gjyqësore (2002), Rekomandimi CM/REC (2010) 12 i Komitetit të Ministrave për Shtetet Anëtare, i titulluar “Gjykatësit: Pavarësia, Efikasiteti dhe Përgjegjësitë”, dhe rregulla e norma të tjera ndërkombëtare dhe vendore për etikën gjyqësore dhe të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm;

Pajtohen për sa vijon më poshtë:

Kreu 1

Dispozita të përgjithshme

Neni 1

Miratimi i kodit

Gjykatësit e kanë miratuar këtë kod bazuar në paragrafin 6 të nenit 19 të Ligjit dhe në përputhje me paragrafin 4 të nenit 31 të Ligjit, dhe interpretimi i këtij kodit bëhet në kontekst të përbashkët të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit, dhe Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ('Rregullorja').

Neni 2

Përdorimi i termave

Në kuadër të këtij Kodi të Etikës Gjyqësore, termat e përdorura në këtë tekst kanë kuptimet e përcaktuara në rregullën 2 të Rregullores. Njëjësi përfshin shumësin dhe anasjelltas.

Kreu 2

Parimet kryesore

Neni 3

Pavarësia

- (1) Në ushtrimin e detyrave të tyre gjyqësore, gjykatësit janë të pavarur nga çfarëdo autoriteti apo ndikimi.
- (2) Në ushtrimin e detyrave të tyre gjyqësore, gjykatësit ruajnë pavarësinë e funksionit të tyre dhe autoritetin e Dhomave të Specializuara dhe veprojnë në përputhje me to.
- (3) Gjykatësit nuk ndërmarrin asnjë veprimtari që ka të ngjarë të ndërhyjë në detyrat e tyre gjyqësore, ose të ndikojë në besimin mbi pavarësinë e tyre dhe respektin për postin e tyre si gjykatës.

Neni 4

Paanësia

- (1) Gjykatësit i ushtrojnë detyrat e tyre në mënyrë të paanshme dhe mundësojnë që kjo paanësi të jetë e dukshme.
- (2) Gjykatësit shmangin çfarëdo autoriteti të konflikteve të interesave, si edhe situata që logjikisht mund të perceptohen se shkaktojnë konflikt interesash.

Neni 5**Ndershmëria**

- (1) Gjykatësit sillen me korrektesë dhe ndershmëri, në pajtim me kriterin e moralit të lartë për postin e tyre si gjykatës.
- (2) Gjykatësit nuk pranojnë, ofrojnë ose japin, drejtpërsëdrejti apo tërthorazi, dhurata, favore, privilegje ose shpërblime që logjikisht mund të konsiderohen se synojnë të ndikojnë në kryerjen e detyrave të tyre gjyqësore.
- (3) Gjykatësit i trajtojnë gjykatësit e tjerë, palët, pjesëmarrësit në procedura, punonjësit e Dhomave të Specializuara dhe të tjerët, me dinjitet dhe respekt dhe nuk kryejnë diskriminim, keqtrajtim, ndër të tjera edhe keqtrajtim seksual, dhe shpërdorim të pozitës zyrtare në asnjë lloj forme. Udhëzuesi kundër Ngacmimit i Dhomave të Specializuara të Kosovës zbatohet *mutatis mutandis* edhe për gjykatësit.
- (4) Gjatë gjithë kohës, gjykatësit sillen me njëri-tjetrin në frymën e kolegjalitetit dhe profesionalizmit.
- (5) Gjatë gjithë kohës, gjykatësit janë të ndërgjegjshëm për detyrimin e tyre në lidhje me mbrojtjen e statusit dhe të emrit të Dhomave të Specializuara.
- (6) Gjykatësit të cilët janë objekt i një hetimi, procedure ose sanksioni disiplinor apo në lidhje me vendin e punës për sjellje të mundshme kundërvajtëse në çfarëdo juridiksioni, i japin informacionin e plotë përkatës Kryetarit. Në qoftë se rasti është ende në fazën hetimore, gjykatësi e informon Kryetarin në kohë për çfarëdo zhvillimesh.

Neni 6**Fshehtësia**

Gjykatësit bëjnë çmos që të jenë sa më të matur dhe të ruajnë konfidencialitetin e këshillimeve në kuadër të detyrave të tyre gjyqësore, fshehtësinë e kuvendimeve dhe të informacionit të mësuar gjatë kryerjes së detyrave të tyre, jashtë procedurave publike.

Neni 7**Zelli**

- (1) Pas caktimit në një trup gjykues, gjykatësit u japin detyrave të tyre gjyqësore përparësi kundrejt të gjitha veprimtarive të tjera. Në raste të tilla, gjatë ushtrimit të detyrës së tyre gjyqësore, gjykatësit veprojnë me zell dhe veprimtarinë e tyre profesionale ua përkushtojnë këtyre detyrave.
- (2) Gjykatësit ndërmarrin të gjitha hapat e arsyeshëm për ruajtjen dhe zgjerimin e dijenive, aftësive dhe cilësive personale të nevojshme për postin e tyre gjyqësor.
- (3) Gjykatësit i kryejnë të gjitha detyrat gjyqësore në mënyrë të përshtatshme, efikase dhe të shpejtë dhe nuk ndërmarrin veprime të papajtueshme me ushtrimin e zellshëm të detyrave të tyre.
- (4) Gjykatësit i shpallin vendimet e tyre në mënyrë të drejtë e të paanshme, brenda një kohe të arsyeshme dhe duke shmangur vonesat e panevojshme.

- (5) Gjatë gjithë kohës, gjykatësit e kryejnë veprimtarinë e tyre me synim efektivitetin e Dhomave të Specializuara.

Neni 8

Veprimtaria gjatë procedurave gjyqësore

- (1) Gjatë procedurave gjyqësore, gjykatësit mbajnë rregullin, veprojnë në pajtim me normat e mirësjelljes, janë të vëmendshëm, të duruar, me dinjitet, respektues dhe mirëdashës kundrejt të gjithë pjesëmarrësve në procedura dhe publikut të pranishëm dhe kërkojnë prej tyre të njëjtën sjellje.
- (2) Gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarëve ose viktimave, gjykatësit ushtrojnë syçelësi ndaj mënyrës së pyetjeve në pajtim me Rregulloren dhe u kushtojnë vëmendje dhe kujdes të posaçëm të drejtave dhe interesave të pjesëmarrësve në procedura. Gjykatësit tregohen veçanërisht të vëmendshëm kundrejt dëshmitarëve të cenushtëm, ndër të cilët viktimat e dhunës seksuale dhe gjinore si edhe fëmijët.
- (3) Me aq sa është e mundur, gjykatësit garantojnë që cilido pjesëmarrës në procedura nuk bën komente apo nuk kryen sjellje poshtëruese.

Neni 9

E drejta e shprehjes dhe pjesëmarrjes në shoqata

- (1) Gjykatësit e ushtrojnë lirinë e tyre të shprehjes dhe të pjesëmarrjes në shoqata në pajtueshmëri me postin e tyre dhe në një mënyrë që nuk ndikon, ose që duket se nuk ndikon në pavarësinë, ose paanësinë e tyre gjyqësore.
- (2) Ndonëse gjykatësit janë të lirë të marrin pjesë në debate publike mbi tema juridike, nëpërmjet botimeve akademike, gjyqësorin apo administrimin e drejtësisë, ata nuk bëjnë komente për çështje gjyqësore në procedim e sipër, sigurojnë që sjellja e tyre nuk tregon kurrfarë mungese respekti për pikëpamjet e një gjykatësi apo punonjësi tjetër dhe i shmangen shprehjes së pikëpamjeve që cenojnë statusin dhe ndershmërinë e Dhomave të Specializuara.
- (3) Në ushtrimin e lirisë së tyre të shprehjes, gjykatësit nuk bëjnë deklarata ose komente publike që mund të cenojnë autoritetin e Dhomave të Specializuara, apo që mund të shkaktojë dyshime të arsyeshme mbi paanësinë e tyre.
- (4) Para se të komunikojnë me shtypin apo mediat mbi çështje që kanë lidhje me Dhomat e Specializuara, gjykatësit kërkojnë paraprakisht miratimin prej Kryetarit.

Neni 10

Veprimtari të tjera

Në pajtim me paragrafin 4 të nenit 26 të Ligjit, çfarëdo veprimtarie e ndërmarrë prej gjykatësve jashtë Dhomave të Specializuara duhet të jetë në pajtim me detyrat e tyre gjyqësore dhe funksionimin efikas dhe në kohë të Dhomave të Specializuara.

Neni 11**Dekoratat dhe çmimet**

Gjykatësit janë të lejuar të pranojnë dekorata dhe çmime vetëm kur ato nuk shkaktojnë dyshim të arsyeshëm në lidhje me pavarësinë ose paanësinë e tyre. Para pranimit të këtyre dekoratave ose çmimeve, ata informojnë Kryetarin.

Neni 12**Respektimi i kodit**

- (1) Parimet e mishëruara në këtë kod vlejnë në çdo kohë për gjykatësit dhe vijojnë të mbeten në fuqi edhe për ish-gjykatësit, për shembull në ruajtjen e fshehtësisë së kuvendimeve ose mosnxjerrjen e dokumenteve konfidenciale.
- (2) Në rast dyshimi mbi zbatueshmërinë e këtyre parimeve në një situatë konkrete, gjykatësi në fjalë këshillohet me Kryetarin.
- (3) Në këtë kod nuk ka asgjë që synon të kufizojë ose pakësojë pavarësinë gjyqësore të gjykatësve.

Kreu 3**Sjellje kundërvajtëse****Neni 13****Sjellje kundërvajtëse të rënda**

- (1) Sjellje kundërvajtëse të rënda përbëjnë ato forma sjelljeje që:
 - (a) janë të papajtueshme me detyrat zyrtare dhe shkaktojnë, ose ka të ngjarë t'i shkaktojnë dëm të rëndë administrimit të duhur të drejtësisë në Dhomat e Specializuara apo funksionimit të brendshëm të duhur të Dhomave të Specializuara, si për shembull:
 - (i) nxjerrja e fakteve ose të dhënave që gjykatësit i kanë mësuar gjatë ushtrimit të detyrës së tyre gjyqësore, ose në lidhje me një çështje që është duke u gjykuar në Dhomat e Specializuara, në qoftë se një veprim i tillë dëmton procedurën gjyqësore ose cilindo person;
 - (ii) fshehja ose mosdhënia e informacionit ose e rrethanave të tilla që mund të kishin çuar në përjashtimin e gjykatësit nga mbajtja e një posti;
 - (iii) shpërdorimi i postit gjyqësor për të përfituar trajtim favorizues nga autoritete, zyrtarë apo profesionistë; ose
 - (b) janë aq të rënda sa shkaktojnë ose ka të ngjarë t'i shkaktojnë dëm të rëndë statusit të Dhomave të Specializuara, si:
 - (i) kryerja e një vepre penale që ndikon për keq në ndershmërinë dhe besueshmërinë e gjykatësit;

- (ii) kryerja e veprimeve ku përfshihet keqtrajtimi, shpërdorimi i pushtetit, pandershmëria, mashtrimi ose shtrembërimi.
- (2) Gjykatësi përjashtohet nga Regjistri në pajtim me nenin 21, në qoftë se konstatohet se ka kryer sjellje kundërvajtëse të rëndë sipas paragrafit 1.

Neni 14

Sjellje kundërvajtëse më pak të rënda

- (1) Sjellje kundërvajtëse më pak e rëndë është kur:
- (a) shkakton ose ka të ngjarë t'i shkaktojë dëm administrimit të duhur të drejtësisë në Dhomat e Specializuara ose funksionimit të brendshëm të duhur të Dhomave të Specializuara, si:
 - (i) orvatje për ndikim të papërshtatshëm ndaj një gjykatësi tjetër, Kryetarit, Prokurorit të Specializuar ose Administratorit, në ushtrimin e detyrave të tyre;
 - (ii) mospërmbushja ose shpërfillja e përsëritur e kërkesave të kryegjykatësit, ose të Kryetarit gjatë ushtrimit të pushtetit të tyre të ligjshëm;
 - (iii) komunikim me shtypin ose median për tema që kanë të bëjnë me Dhomat e Specializuara, pa kërkuar paraprakisht leje nga Kryetari;
 - (iv) fshehje ose mosdhënie e informacionit që duhet të bëhet i njohur në bazë të nenit 5(5); ose
 - (b) shkakton, ose ka të ngjarë t'i shkaktojë dëm statusit të Dhomave të Specializuara.
- (2) Në rast se konstatohet se një gjykatës ka kryer sjellje kundërvajtëse më pak të rëndë bazuar në paragrafin 1, ndaj gjykatësit në fjalë merren masa disiplinore në pajtim me nenin 22.

Kreu 4

Procedura disiplinore

Neni 15

Ankesat

- (1) Ankesë në lidhje me sjelljen e përcaktuar në nenin 13 ose 14, mund të paraqitet prej çdo gjykatësi, punonjësi, pale apo pjesëmarrësi në procedurat para Dhomave të Specializuara, prej Administratorit ose cilitdo personi tjetër që pretendon se të drejtat ose interesat e tij janë cenuar nga sjellja kundërvajtëse e pretenduar ('Ankuesi').
- (2) Kryetari gjithashtu ka të drejtë të nisë procedim disiplinor *proprio motu*.
- (3) Ankesat bazuar në paragrafin 1 i dorëzohen Kryetarit. Në rast se ankesa paraqitet kundër vetë Kryetarit, për qëllimet e këtij Kreu, kompetencat e Kryetarit i merr nënkryetari.
- (4) Ankesa paraqitet brenda gjashtë muajsh pasi Ankuesi logjikisht duhet të ketë ditur për ekzistencën, ose kryerjen e kundërvajtjes së pretenduar. Ankesa mund të merret në shqyrtim pas këtij afati, në qoftë se çështja është e rëndësishë së përgjithshme për Dhomat e Specializuara.

- (5) Ankesa paraqitet me shkrim dhe:
- (a) identifikon Ankuesin dhe gjykatësin kundër të cilit paraqitet ankesa ('Gjykatësi Përgjigjës');
 - (b) përmend dispozitën/dispozitat ligjore mbi të cilën/të cilat bazohet, në qoftë se është e mundshme;
 - (c) përshkruan në hollësi të mjaftueshme sjelljen kundërvajtëse të pretenduar të Gjykatësit Përgjigjës; dhe
 - (d) përfshin provat përkatëse.

Neni 16

E drejta për t'u mbrojtur

Gjatë gjithë procedimit disiplinor, Gjykatësi Përgjigjës mund të përfaqësohet nga një mbrojtës, me shpenzime të veta. Atij i mundësohet të bëjë parashtrime, të paraqesë prova dhe t'u përgjigjet pyetjeve që i bëhen.

Neni 17

Hedhja poshtë e ankesave me procedurë të shkurtuar

- (1) Në qoftë se ankesa është e paemër, ose Kryetari gjykon se ankesa është qëllimkeqe, e gabuar, e pavlerë apo e pabazë, ose e paraqitur jashtë afatit, ai e hedh poshtë kërkesën me procedurë të shkurtuar sa më shpejt që të jetë e mundur dhe jo më vonë se dy javë pas marrjes së saj. Ankuesi njoftohet për hedhjen poshtë dhe arsyet e hedhjes poshtë të ankesës.
- (2) Në qoftë se Kryetari gjykon se ankesa nuk është *prima facie* qëllimkeqe, e gabuar, e pavlerë apo e pabazë, ose nëse Kryetari ka filluar procedim disiplinor *proprio motu*, ankesa i dorëzohet Gjykatësit Përgjigjës jo më vonë se dy javë pas marrjes së saj, apo pas fillimit *proprio motu* të procedimit sipas paragrafi 2 të nenit 15. Gjykatësi Përgjigjës ka të drejtë të paraqesë mendimin e vet në lidhje me ankesën brenda dy javësh pas marrjes së ankesës.
- (3) Kryetari nxjerr vendimin mbi ankesën brenda dy javësh pas marrjes së mendimit të Gjykatësit Përgjigjës. Në qoftë se Kryetari gjykon se ankesa është qartazi e pabazë dhe nuk mbështetet në fakte, ai e hedh poshtë me procedurë të shkurtuar. Vendimi i Kryetarit u komunikohet Ankuesit dhe Gjykatësit Përgjigjës.
- (4) Vendimet e marra në bazë të këtij neni nuk rishikohen.

Neni 18

Komisioni Disiplinor

- (1) Kur Kryetari nuk e hedh poshtë ankesën me procedurë të shkurtuar përcaktuar sipas nenit 17, ai cakton një komision disiplinor të cilit ia kalon ankesën.

- (2) Komisioni Disiplinor përbëhet nga tre anëtarë, ku të paktën dy prej të cilëve nga gjyqësori, që Kryetari i zgjedh ose nga gjykatësit e gjykatave ndërkombëtare ose të ndërkombëtarizuara, apo nga gjykatësit e gjykatave vendore me përvojë të gjerë në etikën profesionale ose në hetimin e sjelljes kundërvajtëse në kryerjen e detyrës. Anëtar i tretë mund të jetë i emëruar i lartë i Bashkimit Evropian. Kryetarit nuk i lejohet të jetë anëtar i këtij komisioni. Komisioni Disiplinor zgjedh kryesuesin e vet.
- (3) Komisioni Disiplinor heton pretendimet e paraqitura në ankesën e përcjellë nga Kryetari.
- (4) Gjatë hetimit që kryen, komisioni disiplinor:
 - (a) i mundëson Gjykatësit Përgjigjës paraqitjen e sqarimeve me shkrim dhe të provave në përgjigje të ankesës;
 - (b) mund ta urdhërojë Gjykatësin Përgjigjës:
 - (i) të paraqesë libra, dokumente, materiale, shënime, llogari ose dokumentacion që ai disponon ose që janë në kontrollin e tij, lidhur me lëndën e ankesës; Komisioni Disiplinor mund të verifikojë dhe të mbajë çfarëdo dokumentacioni të marrë në këtë mënyrë për një periudhë që e gjykon të arsyeshme për nevojat e hetimit; ose
 - (ii) ndryshe, të ndihmojë ose bashkëpunojë rreth hetimit në një mënyrë konkrete;
 - (c) sipas nevojës, ka të drejtë të intervistojë cilindo person; dokumenton çdo intervistë duke përfshirë edhe identitetin e të intervistuarve; dhe
 - (d) ka të drejtë ta urdhërojë Administratorin që t'i mundësojë qasje në të dhënat elektronike dhe në çdo dokumentacion tjetër të Dhomave të Specializuara të Kosovës në lidhje me shkeljet disiplinore të pretenduara.
- (5) Brenda gjashtë javësh pas marrjes së ankesës, komisioni disiplinor ia përcjell përfundimet paraprake Gjykatësit Përgjigjës dhe i mundëson që të përgjigjet, ose të paraqesë prova plotësuese brenda dy javësh pas marrjes së përfundimeve paraprake.
- (6) Brenda dhjetë javësh pas marrjes së ankesës, komisioni disiplinor i dorëzon Kryetarit raport të hollësishëm në lidhje me përfundimet e hetimit. Raporti përmban rekomandime për çdo pretendim të paraqitur në ankesë kundër Gjykatësit Përgjigjës, si edhe propozim për masa disiplinore konkrete të mundshme.
- (7) Komisioni disiplinor dokumenton çdo hakmarrje apo kërcënim për hakmarrje kundër cilitdo ankuesi apo personi të përfshirë në procedurën lidhur me ankesën.
- (8) Raporti u përcillet Ankuesit dhe Gjykatësit Përgjigjës.

Neni 19

Pezullimi nga detyra

Nëse ankesa që i përcillet komisionit disiplinor përmban pretendime për sjellje kundërvajtëse të rëndë, përcaktuar në nenin 13, Kryetari mund ta pezullojë nga detyra Gjykatësin Përgjigjës deri në përfundimin e hetimit të komisionit disiplinor, ose deri në daljen e vendimit të gjykatësve të mbledhur

në seancë plenare, në përputhje me nenin 21. Pezullimi nga detyra nuk ndikon në të drejtën e shpërblimeve dhe mëditjeve.

Neni 20

Seanca plenare

- (1) Kur komisioni disiplinor nxjerr përfundimin se Gjykatësi Përgjigjës ka kryer një apo më shumë prej shkeljeve të pretenduara në ankesë, këtë raport Kryetari ia përcjell menjëherë gjykatësve të mbledhur në seancë plenare.
- (2) Pas kuvendimeve lidhur me pretendimet në ankesë, gjykatësit votojnë. Gjykatësit e mbledhur në seancë plenare marrin vendimin brenda katër javësh pas marrjes së raportit.
- (3) Si Ankuesi në qoftë se është gjykatës, po ashtu edhe Gjykatësi Përgjigjës, mund të marrin pjesë në seancën plenare, por nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në kuvendime, e as të votojnë. Gjykatësi Përgjigjës ka të drejtë të mbrohet, t'u përgjigjet pyetjeve që i bëhen, apo të japë sqarime plotësuese.

Neni 21

Përrjashtimi nga Regjistri

- (1) Kur gjykatësit konstatojnë se janë vërtetuar një apo më shumë pretendime sipas nenit 13, gjykatësit e mbledhur në seancë plenare, me shumicë absolute të gjykatësve të Regjistrit me të drejtë vote, marrin vendimin për përjashtimin e Gjykatësit Përgjigjës nga Regjistri, në përputhje me paragrafin 4 të nenit 31 të Ligjit.
- (2) Përrjashtimi nga Regjistri hyn në fuqi menjëherë. Gjykatësi Përgjigjës pushon së qeni gjykatës i Dhomave të Specializuara, dhe i cilëso çështjeje të papërfunduar në të cilën është caktuar.

Neni 22

Masat disiplinore

- (1) Kur gjykatësit konstatojnë se janë vërtetuar një apo më shumë pretendime sipas nenit 14, gjykatësit e mbledhur në seancë plenare, me shumicë absolute të gjykatësve pjesëmarrës me të drejtë vote, marrin vendimin lidhur me masat disiplinore të përcaktuara në paragrafin 2, kundër Gjykatësit Përgjigjës.
- (2) Masat disiplinore që mund të merren janë si më poshtë:
 - (a) qortim zyrtar dhe me shkrim nga gjykatësit e mbledhur në seancë plenare;
 - (b) i dërgohet raport shtetit që ka emëruar dhe mbështetur aplikimin e gjykatësit për përfshirje në Regjistër;
 - (c) pezullim nga detyra në Dhomat e Specializuara për një periudhë të përcaktuar të përshtatshme, por jo më gjatë se një vit;

- (d) u dërgohet raport institucioneve profesionale ku me gjasë Gjykatësi Përgjigjës është anëtar; dhe/ose
- (e) gjobë deri në 2,000 Euro.

Kreu 5

Dispozitë përmbyllëse

Neni 23

Klasifikimi i procedurave

- (1) Në qoftë se nuk përcaktohet ndryshe, të gjitha parashtrimet, vendimet dhe urdhrat në lidhje me këtë regjim disiplinor dorëzohen konfidencialisht, në një nga gjuhët zyrtare të Dhomave të Specializuara. Dokumentacioni i procedurave të kryera sipas këtij regjimi disiplinor është konfidencial. Zyra Administrative mban të gjithë dokumentacionin për qëllime të këtij regjimi disiplinor.
- (2) Me përfundimin e procedurës dhe pasi t'i ketë dëgjuar pjesëmarrësit, Kryetari mund të urdhërojë ndryshimin e statusit konfidencial të procedurës, nëse është në interes të drejtësisë.